

POLICAT E SIGURIMIT KUFITAR PËR DIASPORËN E KOSOVËS

CILAT JANË VËZHGIMET DHE REKOMANDIMET E DIASPORËS?

REKOMANDIMET

Memorandume Ndërkombëtare

Byroja Kosovare e Sigurimeve të lidhë marrëveshje për njohje reciproke të sigurimeve me Gjermaninë, Zvicrën, Austrinë dhe shtete të tjera me prezencë të madhe të diasporës.

Digjitalizim i Policave

Të mundësohet blerja online e policave të sigurimit kufitar, veçanërisht kur ato janë të subvencionuara, për të ulur kohën e pritjes në kufi.

Fushatë Informimi

Qeveria e Kosovës, përmes MPJD dhe përfaqësive diplomatike, të rrisë ndërgjegjësimin e diasporës për vendimet lidhur me sigurimet dhe të parandalojë keqpërdorimet.

AUTORE: NIDA KRASNIQI

Janar 2025

Ky dokument paraqet një përmbledhje të shkurtër të gjendjes lidhur me policat e sigurimit kufitar për diasporën e Kosovës me qëllimin të paraqitjes së opinionëve (feedback-ut) të diasporës për hapat e ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës deri më tani për adresimin e këtij problemi dhe rekomandime konkrete për atë që mbetet të bëhet tutje deri në adresimin e tij.

Një tur horizonti mbi kartonin e gjelbër

Kartoni i Gjelbër është një dokument sigurimi ndërkombëtar që mbulon përgjegjësinë ndaj palëve të treta për dëmet e shkaktuara nga aksidentet rrugore jashtë vendit të regjistrimit të automjetit. Ai siguron mbrojtje financiare për lëndimet trupore dhe dëmtimet materiale të shkaktuara nga shoferët që udhëtojnë në vende të tjera, duke garantuar mbulim të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet ligjore ndaj palëve të treta. Sistemi i Kartonit të Gjelbër u krijua në vitin 1949 me themelimin e Këshillit të Byrove Ndërkombëtare të Sigurimit, i cili aktualisht përfaqëson 47 shtete anëtare. Këto përfshijnë shtetet e Bashkimit Evropian, ato të Zonës Ekonomike Evropiane dhe vende të tjera si Andorra, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Mali i Zi, që janë bashkuar përmes marrëveshjeve specifike¹. Për të qenë pjesë e këtij sistemi, një shtet duhet të anëtarësohet në Këshillin e Byrove.

Qeveria e Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve kanë ndërmarrë një numër hapash konkret për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Byrove, me theks të vecantë në përmbushjen e kushteve ligjore e teknike. Këtu përfshihet

miratimi i legjislacionit të nevojshëm, krijimi dhe mirëbajtja e fondit të kompensimit (të dëmeve), si dhe së fundmi ulja e numrit të veturave të paregjistruara (vecanërisht me implementimin e sistemit të stikerëve). Megjithatë, kushti kryesor i cili ende nuk është përmbushur mbetet një kusht politik: anëtarësimi i Kosovës në Kombet e Bashkuara, dhe derisa kjo të arrihet, sipas Statutit të Këshillit të Byrove, Kosova nuk do të mund të jetë anëtare e Këshillit të Byrove, e rrjedhimisht Sistemit të Kartonit të Gjelbër. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se policat e sigurimeve të Kosovës nuk vlejnë në shtetet anëtare të Këshillit të Byrove dhe ngjashëm, ato të blera jashtë vendit nuk vlejnë në Kosovë (me përjashtim, në të dyja rastet, të atyre shteteve me të cilat Kosova ka marrëveshje për njohjen reciproke të sigurimeve), dhe për të pasur mbulueshmëri të përgjegjësive ndaj palëve të treta, çdo veturë duhet të blejë sigurim shtesë.

Sfidat: çka është bërë deri më tani dhe çka mbetet?

Fakti se Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Byrove paraqet sfidë e vështirësi për qytetarët e saj që jetojnë në Kosovë, por në veçanti për bashkatdhetarët që jetojnë jashtë vendit. Përderisa me liberalizimin e vizave, shumë qytetarë nga Kosova kanë udhëtuar për në shtetet e Bashkimit Evropian dhe janë përballur me këtë kosto shtesë, barra më e madhe financiare është ndjerë nga diaspora. Gjatë çdo vizite në Kosovë, bashkatdhetarët janë detyruar (dhe në parim vazhdojnë të detyrohen) që të paguajnë policën e sigurimit kufitar shtesë për të hyrë në Kosovë. Kjo policë e cila blihet në pikat kufitare, përpos koston financiare shtesë, shkakton edhe rradhë e pritje tejet të gjata gjatë periudhave të fluksit në pikat kufitare të vendit.

Për sa i përket koston financiare, në vitet e fundit Qeveria e Kosovës ka marrë disa vendime për mbulimin e tyre, qoftë përmes subvencionimit të policave të sigurimit kufitar për bashkatdhetarët që hyjnë në Kosovë gjatë periudhës së verës, apo edhe përmes vendosjes së një sistemi të rimbursimit të pagesave. Ky i fundit është cilësuar si joefikas nga diaspora si pasojë e mosfunksionimit të duhur, procedurave të gjata dhe burokratike, dhe mungesës së procedurës së ankimimit në rast nevojë². Në anën tjetër, sistemi i subvencionimit ex-ante, është cilësuar nga diaspora si më efikas dhe i përshtatshëm për zbatim³. Kjo nuk do të thotë, ama, që nuk janë hasur probleme në implementimin praktik. Qeveria nuk ka ndërmarrë hapa adekuatë për informimin e diasporës mbi faktin se polica është e subvencionuar, dhe shumë herë diaspora është detyruar të paguajë policën në pikën kufitare. Në këtë drejtim, organizatat e shoqërisë civile⁴, analistët e ekonomisë⁵, mërgimtarët e edhe qytetarët e Kosovës që jetojnë në Kosovë poashtu janë shprehur të pakënaqur me faktin se Qeveria e Kosovës po dedikon një shumë domethënëse nga buxheti i Kosovës i cili vie nga tatimpaguesit, për të financuar këto kosto (që nuk janë bazike por luksi) dhe përfundimisht, me qëllim për të financuar kompanitë e sigurimeve.

Në të njëjtën formë, nuk ka pasur informim të duhur mbi procedurat ankimore administrative në rast të keqpërdorimeve apo për probleme me rimbursimin në rastin kur ky sistem u pati implementuar (përkundrazi qytetarët janë inkurajuar që këto raste ti lajmërojnë në polici)⁶. Në anën tjetër, vlen të theksohet se për një pjesë të konsiderueshme të diasporës së Kosovës, kostoja edhe mund të përballohet, por, ajo që paraqet problem universal për të gjithë është koha e humbur në pritje të gjata në pikat kufitare meqenëse sigurimet e subvencionuara nuk mund të merren online.

Krejt në fund por jo nga rëndësia, duhet theksuar se përderisa Kosova ka lidhur memorandume bashkëpunimi për njohjen reciproke të sigurimeve me: Malin e Zi, Maqedoninë, Shqipërinë, dhe Serbinë, deri më tani nuk ka ndonjë informacion publik mbi veprimet e mundshme të marra nga Byroja e Sigurimeve të Kosovës për të forcuar bashkëpunimin bilateral në fushën e sigurimeve me shtetet anëtare të Këshillit të Byrove.

2 Kjo çështje është ngritur nga takimi me diasporën lidhur me këtë temë, i organizuar nga GERMIN me datë 21 tetor 2024 në platformën Zoom. Shih fusnotën 4 ku mund të shihet edhe reagimi i Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, z. Hekuran Murati.

3 Idem.

4 Group for Legal and Political Studies - [REAGIM: Kundërshtim ndaj vendimit të Qeverisë për subvencionimin e sigurimit të automjeteve të huaja që hyjnë në Kosovë me përfitues individët privat](#)

5 Kritikohet subvencionimi i polisës kufitare për diasporën: ["Nga taksat e qytetarëve të varfër të Kosovës" - NACIONALE](#)

6 [Reagim i Ministrit Hekuran Murati, dt. 6 gusht 2024](#)

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ato shtete në të cilat ka prezencë të madhe të diasporës kosovare.

Rekomandimet për institucionet përkatëse

Edhe pse ka pasur paralelisht lëvizje të konsiderueshme drejt anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Byrove dhe sistemin e Kartonit të Gjellbër, si dhe hapa të ndërmarrë për të ulur kostot e diasporës lidhur me policat e sigurimit kufitar, këto janë konsideruar si të pamjaftueshme dhe ad-hoc nga ana e diasporës dhe vepërimit në vijim rekomandohet të ndërmerren nga institucionet përkatëse:

- Marrë parasysh se pa anëtarësim në Kombet e Bashkuara Kosova nuk mund të anëtarësohet në Këshillin e Byrove, Byroja Kosovare e Sigurimeve duhet, në përputhje me prioritetin e saj strategjik⁷, të lidhë memorandume për njohjen reciproke të sigurimeve me shtetet me prezencë më të madhe të diasporës së Kosovës (siç janë Gjermania, Zvicra⁸, e Austria);
- Byroja Kosovare e Sigurimeve të investojë në digjitalizimin e sistemit dhe të mundësojë marrjen online të policave të sigurimit kufitar kur ato janë të subvencionuara, me qëllim të zvogëlimit të kohës së pritjes në pikat kufitare; dhe
- Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Ambasadave e Konsullatave të Kosovës në vendet e huaja, të angazhohet për informim të duhur dhe ndërgjegjësim të mërgimtarëve lidhur me vendimet e marra, ashtu që të mos ketë hapësirë për keqpërdorime të mundshme.

Është evidente se përpjekjet e deritanishme të Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera relevante, megjithëse të dobishme, nuk kanë arritur të adresojnë në mënyrë të plotë nevojat dhe pritshmëritë e diasporës. Për më tepër, nuk janë ndërmarrë as masa për të fuqizuar bashkëpunimin institucional me shtetet tjera ku ka prezencë të diasporës kosovare. Për të tejkaluar këto sfida, kërkohet një qasje proaktive nga institucionet e përfshira në zbatimin e rekomandimeve të listuara më lartë. Vetëm përmes këtyre masave Kosova mund të sigurojë mbështetje efektive për diasporën dhe të adresojë plotësisht sfidat e krijuara nga mospjesëmarrja në Sistemin e Kartonit të Gjellbër.

7 [Kartoni i Gjellbër – Byroja Kosovare e Sigurimit](#)

8 Biles, qysh nga viti 2015, diaspora e Kosovës në Zvicër ka ofruar mbështetje ndaj institucioneve përkatëse lidhur me këtë çështje: Kartoni i gjellbër : [Letër të hapur për ministrin e Diasporës - Albinfo](#)



Kjo analizë u realizua me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor" të zbatuar nga Qendra për Promovimin Shoqërisë Civile (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA). Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA).

